

VENDIM

Nr.808, date 4.12.2003

PER DHENIEN E DESHMIVE TE AFTESISE PERDORUESVE TE MAKINERIVE TE RENDA TE NDERTIMIT

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te nenit 18 te ligjit nr.8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit" dhe te nenit 6 te ligjit nr.8872, date 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit te Rregullimit te Territorit dhe te Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi fizik, qe ushtron profesionin e manovruesit te makinerive te renda te ndërtimit,

duhet te jete i pajisur me deshmi aftesie.

2. Shfuqizohet.

3.a) Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor të ngrihet komisioni i posaçëm për dhënie e dëshmisë së aftësisë, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit.

b) Kushtet dhe kriteret për dhënie e dëshmisë së aftësisë përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit përcaktohen në rregulloren, që do të hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe do të miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit."

4. Kurset teorike e praktike, për përgatitjen e manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike private, që plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren e përmendur në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij vendimi."

5. Shfuqizohet.

6. Përdorimi i makinerive te renda pa deshmine e aftesise përbën dhe ndëshkohet si shkelje e

rregullave te sigurimit teknik ne ndërtim.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

